



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.
(“KEK”)

**POLITIKAT STANDARDE TË OPERIMIT PËR KOMISIONIN E AUDITIMIT TË
BORDIT TË DREJTORËVE TË KEK-UT**

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Në pajtim me kompetencat e paraqitura në Nenin 26 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) (“**Ligji për NP**”), Komisioni i Auditimit të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut ka nxjerrë dhe ka aprovuar, përmes vendimit të datës 16 dhjetor 2009, politikat dhe procedurat vijuese, të cilat do të aplikohen në punën e Komisionit të Auditimit. (“**PSO ose Politikat e Auditimit**”).
- 1.2 Këto Politika të Auditimit do të hyjë në fuqi më datën 1 janar 2010.
- 1.3 Këto Politika të Auditimit duhet të lexohen në lidhje me kornizën rregullative të korporatës, e cila zbatohet në Republikën e Kosovës, duke përfshirë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 2008/03-L-087 dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 2007/02-L-123 dhe rregulloret e Kompanisë, Kodin për Qeverisjen e Korporatës, ashtu siç mund të ndryshohen kohë pas kohe. Në rast se ndonjë prej dispozitave në këto Politika të Auditimit është në konflikt me dispozitat e dokumenteve të sipërpërmendura, atëherë do të mbizotërojnë dokumentet e mëparshme.
- 1.4 Përveç politikave dhe procedurave të paraqitura këtu, Komisioni i Auditimit do të bëjë përpjekje që të zbatojë praktikat më të mira të auditimit të brendshëm dhe do të marrë parasysh dispozitat e Ligjit të Kosovës për Auditimin e Brendshëm (Ligji Nr. 2009/03-L-128) aq sa ata ato mos kundërshtojnë as Politikat e Auditimit e as përmbajtjen e dokumenteve të tjera të përmendura në paragrafin 1.2 më sipër.
- 1.5 Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Ligjin për NP-të ose rregulloret e KEK-ut do të kenë të njëjtin kuptim dhe fuqi atëherë kur përdoren në Politikat e Auditimit e Auditimit, përveç në rastet kur kjo shprehet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

- 1.6 Në pajtim me Nenin 26(c) të Ligjit për NP, Seksioni IV.4(c) të Rregulloreve, dhe Seksioni III.8(h) i Kodit për Qeverisjen e Korporatës, Komisioni i Auditimit do të kërkojë këshilla nga këshilltari(ët) specialistë, të cilët nuk janë punëtorë të KEK-ut për të ushtruar mandatin e tyre (“Këshilltari(ët) Specialist(ë)”). Këshilltari(ët) Specialist(ë) duhet të kenë përvojë të mirë ndërkombëtare në financa dhe praktikat e kontabilitetit, bashkë me njohuri të mirë në praktikat më të mira të auditimit, dhe ata do të emërohen nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut.

2. TAKIMET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

- 2.1 Në pajtim me Seksionin IV.5 të Rregulloreve, Komisioni i Auditimit do të takohet së paku një herë në muaj, para çdo takimi të paraparë me Bordin e Drejtorëve, zakonisht së paku 3 ditë para atij takimi, dhe do të planifikojë takimet e tij në këtë mënyrë.
- 2.2 Përveç kësaj, dhe në pajtim me Seksionin IV. 5(a) të Rregulloreve dhe Seksionin III.8(g) të Kodit për Qeverisjen e Korporatës, Komisioni i Auditimit do të caktojë edhe takime të tjera shtesë, nëse kjo kërkohe për të kryer obligimet e tij. Duke e ditur këtë, takimet e paplanifikuara ose të jashtëzakonshme do të mbahen atëherë kur çështja është urgjente dhe e rëndësishme, e cila kërkon vendim nga Komisioni i Auditimit dhe e cila nuk mund të presë deri në takimin tjetër të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të kufizohet sipas çështjes(eve) për të cilat edhe mbahet ai takim.
- 2.3 Njoftimi për takim të Komisionit të Auditimit do të caktojë edhe rendin e ditës dhe do të shpërndahet së paku tri ditë para mbajtjes së takimit, qoftë me dorë, faks ose email, ose ndonjë mjet tjetër që siguron pranimin e këtij rendi të ditës. Njoftimet duhet të dorëzohen te të gjithë anëtarët e Komisionit të Auditimit dhe Këshilltarët Specialistë. Në rast të urgjencës, njoftimi për takim do të përcillet nëpërmjet një letre apo faksi, apo edhe email-i, së paku një ditë para mbajtjes së takimit. Komisioni i Auditimit do të takohet në zyrën e vogël të takimeve, në katin e dytë të Ndërtesës së Elektrokosovës, Bulevardi Bill Klinton, Prishtinë, me përjashtim kur jepet njoftim me shkrim se do të mbahet diku tjetër.
- 2.4 Në secilin takim që do të mbahet para takimit të rregullt të Bordit të Drejtorëve, Komisioni i Auditimit do të rishikojë – përveç dokumenteve të përgatitura nga Drejtori Menaxhues për Bordin e Drejtorëve – raportet nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm lidhur me çështjet specifike që janë pjesë e kompetencës së tyre. Kryesuesi i Komisionit të Auditimit do të rishikojë dokumentet e dorëzuara nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm para se të mbahet takimi, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkojë sqarime ose informacione shtesë nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm.
- 2.5 Në fillim të çdo takimi, kryesuesi i Komisionit të Auditimit do të konstatojë prezencën e kuorumit, do ta drejtojë debatin dhe regjistrimin e pjesëmarrësve,

përkujdeset për procesverbalin e detajizuar dhe do të konstatojë e deklarojë rezultatin e votimit. Kryesuesi mund që brenda lirisë së tij ose saj të veprimt të ndihmohet nga Këshilli i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës. Procesverbali i çdo takimi do të përfshijë së paku informacionet vijuese:

- (a) Një përshkrim i shkurtër i temave të të gjitha diskutimeve;
- (b) Të gjitha propozimet e bëra nga pjesëmarrësit në takim;
- (c) Rezultatet e votimit dhe tekstin e të gjitha vendimeve të adaptuara;
- (d) Çdo çështje tjetër, e cila ngritet nga pjesëmarrësit gjatë takimit.

2.6 Komisioni i Auditimit zgjidhet sipas fuqisë ligjore, me prezencën e, dhe do të veprojë me votën pohuese/afirmative të dy (2) anëtarëve në zyrë. Anëtarët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe ata të cilët kanë shpalosur një konflikt interesi, nuk do të marrin pjesë në llogaritjen sipas shumicës. Në rast të votimit të barabartë, kryesuesi ka të drejtën e votës vendimtare.

2.7 Takimet e Komisionit të Auditimit mund të mbahen në më shumë se një lokacion, ku zyrat do të lidhen me video ose audio pajisje, nëse plotësohen kërkesat vijuese dhe nëse ato pasqyrohen në procesverbalet përkatëse:

- (a) Kryesuesi i takimit duhet të jetë në gjendje të konstatojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë prezentë, do ta kryesojë takimin dhe do të konstatojë e deklarojë rezultatet e votimit;
- (b) Kryesuesi (ose Këshilli i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës, nëse është prezent) i takimit duhet të jetë në gjendje të perceptojë në mënyrë të duhur ngjarjet gjatë takimit; dhe
- (c) Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e poashtu edhe t'i lexojnë, pranojnë ose dërgojnë dokumentet që lidhen me atje (nëse ka).

2.8 Një vendim me shkrim, i nënshkruar nga së paku dy (2) anëtarë të Komisionit të Auditimit, kanë të njëjtën fuqi dhe ndikim aq sa miratimi i një vendimi në një takim të thirrur dhe të mbajtur të Komisionit të Auditimit. Një vendim i tillë mund të përmbajë disa dokumente të cilat kanë të njëjtën formë dhe përmbajtje, ku secili nënshkruhet nga një ose më shumë anëtarë.

2.9 Nëse shihet si e nevojshme nga kryesuesi i Komisionit të Auditimit, takimi mund të ndahet në dy sesione, respektivisht një sesion "i hapur", dhe në një sesion që mbahet "in camera" (i mbyllur). Sesionet "in camera" mund të ndiqen vetëm nga anëtarët e Komisionit të Auditimit, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe Këshilltari(ët) Specialistë. Si sqarim, prezantimi i rekomandimeve nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe diskutimet vijuese dhe marrja e vendimeve nga Komisioni i Auditimit duhet të mbahen në sesion "in camera".

3. ÇËSH TJET E QEVERISJES

- 3.1 Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, në mënyrë që të mbahet objektiviteti dhe paanësia e Komisionit të Auditimit, anëtarët e Komisionit të Auditimit do të jenë në pajtim me parametrat e specifikuar në këtë nen.
- 3.2 Sipas Nenit 26(b) të Ligjit për NP, atëherë kur Komisioni i Auditimit dëshiron të marrë informacione në lidhje me marrëdhëniet afariste të KEK-ut, kjo kërkesë duhet të adresohet te Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe te asnjë punëtor tjetër i KEK-ut.
- 3.3 Bazuar në Nenin 26(a) të Ligjit për NP, Komisioni i Auditimit vetëm do të udhëzojë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm për kryerjen e detyrave dhe veprimeve të cilat janë pjesë e kompetencave të Komisionit të Auditimit. Prandaj, Komisioni i Auditimit duhet t'i shmanget dhënies së instruksioneve ose urdhëresave të drejtpërdrejta së personelit të KEK-ut, apo stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm, përveç të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.
- 3.4 Për më tej, gjatë dhënies së urdhëresave për Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm, Komisioni i Auditimit do të veprojë si organ i përbashkët dhe jo individual.
- 3.5 Gjatë dëgjimit të raporteve të Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, Komisioni i Auditimit mund të kërkojë nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm që të ftojë stafin e auditimit të brendshëm për të dhënë informacione shtesë në lidhje me hetimet e caktuara. Megjithatë, përfundimet dhe mendimet në lidhje me çdo çështje të brendshme ose të jashtme do të prezantohen ekskluzivisht nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm.
- 3.6 Anëtarët e Komisionit të Auditimit do t'i shmangen organizimit të takimeve private me stafin e Zyrës së Auditimit të Brendshëm, në mënyrë që të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me punën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm ose Komisionit të Auditimit.
- 3.7 Anëtarët e Komisionit të Auditimit do t'i shmangen marrjes së çdo veprimi, i cili mund të perceptohet si pretendim i një roli ekzekutiv në KEK. Në veçanti, Komisioni i Auditimit nuk do të ndërhyjë në ose dobësojë menaxhimin e Zyrës së Auditimit të Brendshëm nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm, apo në aktivitetet e përditshme të Zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë pa kufizim, caktimin e punëve apo ricaktimin e pozitave të stafit brenda Zyrës së Auditimit të Brendshëm.

4. ORGANIZIMI I ZYRËS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- 4.1 Në pajtim me Nenin 25(i) të Ligjit për NP, Seksioni IV.3(g) i Rregulloreve dhe Seksioni II.5(a) i Kodit për Qeverisjen e Korporatës, Komisioni i Auditimit do të sigurojë se zyra e Auditimit të Brendshëm është e organizuar si duhet dhe e



kompletuar me staf, dhe ai do të verifikojë rregullisht saktësinë dhe funksionimin e saj të duhur dhe do të mbikëqyrë në mënyrë rigorozë dhe të vazhdueshme punën nën drejtimin e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.

4.2 Në vazhdim të paragrafit 4.1:

- (a) Komisioni i Auditimit do të jetë përgjegjës për miratimin zyrtar të skemës organizative dhe numrin e stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm, bazuar në rekomandimet e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.
- (b) Çdo ndryshim në skemën organizative të Zyrës së Auditimit të Brendshëm së pari do të propozohet nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe më pas do të shqyrtohet dhe miratohet nga Komisioni i Auditimit.

4.3 Duke respektuar te drejtën dhe përgjegjësinë për mbikëqyrje të përgjithshme të Komisionit të Auditimit, ashtu siç është paraqitur në paragrafin 4.1, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm do të jetë përgjegjës për emërimin, ngritjen apo uljen në pozitë, dhe largimin e stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm.

4.4 Komisioni i Auditimit do ta mbajë Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm përgjegjës për të siguruar që:

- (a) Stafi i Zyrës së Auditimit të Brendshëm është në përputhje të plotë me kushtet e Kodit të Etikës së KEK-ut; dhe
- (b) Çdo shkelje e Kodit të përmendur ose politikave të tjera të brendshme të KEK-ut nga stafi i Auditimit të Brendshëm do të pasojë me masa përkatëse disiplinore.

Gjatë zbatimit të Kodit të Etikës së sipërpërmendur dhe politikave të brendshme të KEK-ut, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm do të udhëhiqet nga praktikat vijuese, respektivisht natyra e punës së stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm kërkon që ata të mbajnë një nivel të lartë të integritetit dhe etikës, më shumë sesa bashkëpunëtorët e tyre të tjerë në KEK.

5. PAGESA E STAFIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

5.1 Në pajtim me Seksionin IV.3(h) dhe Seksionin III.8(c) të Kodit për Qeverisjen e Korporatës, pagesa e propozuar për Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm do të vendoset nga Komisioni i Auditimit brenda niveleve që mbizotërojnë në treg dhe çdoherë në nivelin që nuk paragjykon aftësinë e KEK-ut për të tërhequr kandidatë që posedojnë aftësitë dhe kompetencat e duhura.

5.2 Duke iu nënshtruar paragrafit 5.1, Komisioni i Auditimit nuk do të vendosë për pagesat e stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm individualisht. Megjithatë, sipas mandatit të tyre të përgjithshëm me Nenin 25(i) të Ligjit për NP, Komisioni i Auditimit, bazuar në rekomandimet e Zyrës së Auditimit të Brendshëm, do të

shqyrtojë dhe aprovojë për çdo vit një Listë të Përgjithshme Pagash për të gjitha pozitat në Zyrën e Auditimit të Brendshëm, duke pasur edhe një shtrirje plus ose minus 15% të pagesës “fikse” për një pozitë. Qëllimi i kësaj është që Zyrtaari i Auditimit të Brendshëm të ketë fleksibilitet gjatë përcaktimit të pagave të stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm, gjithnjë bazuar në performancën e tyre aktuale. Pas rishikimit të Listës së Përgjithshme të Pagave, Komisioni i Auditimit do të drejtohet sipas parimit që pagat duhet të caktohen brenda niveleve që mbizotërojnë në treg dhe çdoherë në nivelin që nuk paragjykon aftësinë e KEK-ut për të tërhequr kandidatë që posedojnë aftësi dhe kompetenca e duhura.

- 5.3 Vlerësimi i performancës së të gjithë stafit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm do të bëhet çdo gjashtë muaj dhe në fundvit, bazuar në parimet dhe direktivat e propozuara nga Zyrtaari i Auditimit të Brendshëm, dhe që do të shqyrtohen dhe miratohen nga Komisioni i Auditimit.
- 5.4 Komisioni i Auditimit, brenda lirisë së tij të veprimit, mund të paraqesë një skemë pagese stimuluese për të shpërblyer stafin e Zyrës së Auditimit të Brendshëm për rezultatet e arritura jashtë orarit të rregullt të punës, dhe në rrethana sfiduese e të rrezikshme. Pagesat stimuluese do të propozohen nga Zyrtaari i Auditimit të Brendshëm dhe do të aprovohen nga Komisioni i Auditimit. Gjatë ushtrimit të lirisë së tyre të veprimit, në pajtim me paragrafin 5.4, Komisioni i Auditimit do të marrë në konsiderim edhe nivelet e pagesave stimuluese që jepen diku tjetër në KEK (nëse ka).

6. KONFIDENCIALITETI

- 6.1 Punët e Komisionit të Auditimit duhet të mbeten konfidenciale, me përjashtim kur Komisioni i Auditimit pajtohet ndryshe. Kjo do të përfshijë çështjet e diskutuara dhe të prezantuara gjatë takimeve të Komisionit të Auditimit. Sipas kësaj, anëtarët e Komisionit të Auditimit nuk do të lejohen të shpalosin ndonjë informacion, që merret gjatë kryerjes së kompetencave të tyre, të një anëtar tjetër prej atyre të Komisionit të Auditimit apo Zyrtaarit të Auditimit të Brendshëm. Por, informacionet konfidenciale mund të shpalosen nëse kjo gjë kërkohet në mënyrë eksplicite me ligjin e Kosovës ose rregullat e ndonjë organi kompetent rregullator apo organi qeveritar apo agjencie, nga të cilat varet KEK-u.
- 6.2 Komisioni i Auditimit do t'i shmanget përfshirjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut në punët e tij, përveç nëse kjo parashihet me ligjin e zbatueshëm, këto POS-e, apo dokumentet korporatave të Kompanisë.

7. VENDIMARRJA, REKOMANDIMET DHE PËRCJELLJA

- 7.1 Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, Komisioni i Auditimit duhet që të marrë vendime të rëndësishme e shpesh edhe të vështira, në lidhje me keqbërjet e punëtorëve të KEK-ut. Gjatë marrjes së vendimeve të tilla, anëtarët e Komisionit të

Auditimit do të injorohet çdo dhe të gjitha presionet ose ndërhyrjet e jashtme dhe të brendshme, të cilat kanë për qëllim të ndikojnë në rezultatin e shqyrtimeve të tyre, përveç këshillave dhe rekomandimeve të prezantuara nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm ose Këshilltari(ët) Specialist(ë).

- 7.2 Zyrtari i Auditimit të Brendshëm do të jetë përgjegjës për raportim në lidhje me statusin e implementimit të çdo vendimi të ndërmarrë nga Komisioni i Auditimit, ose nga Bordi i Drejtorëve, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Auditimit.

8. KOMUNIKIMI

- 8.1 Të gjitha komunikimet me shkrim, duke përfshirë email-at, letrat ose fakset, të cilat dërgohen nga një anëtar i Komisionit të Auditimit gjatë realizimit të kompetencave të tyre, do të kopjohen për të gjithë anëtarët e tjerë të Komisionit të Auditimit dhe çdo Këshilltari(ët) Specialist(ë).

Nënshkruar nga:



Agim Nika – Kryesuesi i Komisionit të Auditimit